

Përmbledhje e Urdhrit për Zhdëmtim në Çështjen

Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës (KSC-BC-2020-04)

1. Ky Urdhër për Zhdëmtim buron nga shpallja e fajësisë së z. Pjetër Shala (z. Shala) më 16 korrik 2024. Z. Shala u shpall fajtor nga ky Trup Gjykues lidhur me tri akuza për krime lufte – konkretisht, ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje e paligjshme – që i kreu si pjesë e ndërmarrjes kriminale të përbashkët, afërsisht midis 17 majit 1999 dhe 5 qershorit 1999, në fabrikën e metalit në Kukës (FMK), një fabrikë e dikurshme për përpunimin e metalit në Kukës, Shqipëri. Z. Shala u dënua me tetëmbëdhjetë (18) vjet burgim, duke iu llogaritur koha e mbajtjes në paraburgim që nga 16 marsi 2021.

Dispozitat ligjore dhe parimet e zbatueshme

2. Trupi Gjykues thekson se qëllimi i zhdëmtimit në Dhomat e Specializuara është jo vetëm ndëshkimi i personit të shpallur fajtor, sikurse parashikohet në nenin 44(6) të Ligjit, por edhe njohja dhe zhdëmtimi, aq sa është e mundur, i dëmit që u është shkaktuar viktimave. Për rrjedhojë, viktimat duhet të marrin zhdëmtim të arsyeshëm, të përshtatshëm dhe të shpejtë.

3. Sa u përket parimeve të zbatueshme lidhur me përgjegjësinë e personit të shpallur fajtor për zhdëmtim, Trupi Gjykues konstaton se urdhri për zhdëmtim nuk mund të dalë jashtë kuadrit të veprave penale për të cilat personi u shpall fajtor dhe duhet të lëshohet në të gjitha rrethanat kundër personit të shpallur fajtor. Përgjegjësia e personave apo organizatave të tjera, ose përgjegjësia e shtetit, nuk është relevante për përcaktimin e përgjegjësisë së personit të shpallur fajtor lidhur me zhdëmtimin.

4. Po kështu, mungesa e mjeteve financiare të personit të shpallur fajtor nuk është relevante për marrjen e këtij vendimi.

Vlerësimi i provave

5. Sa i përket metodologjisë së Trupit Gjykses në vlerësimin e provave, Trupi Gjykses u mbështet në konstatimet faktike dhe ligjore të bëra në Aktgjykim, të cilat çuan në shpalljen e fajësisë dhe dënimin e z. Shala.

6. Trupi Gjykses gjithashtu shqyrtoi Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim, Deklaratën për Pasojat dhe aktekspertizat e dorëzuara nga Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja në lidhje me dëmin e pësuar nga tetë viktimat që kërkojnë zhdëmtim në këtë çështje (viktimat).

Shkalla dhe përmasat e dëmit

7. Sa u përket **shkallës dhe përmasave të dëmit** të pësuar nga viktimat në këtë çështje gjyqësore, Trupi Gjykses shqyrtoi parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave dhe Mbrojtjes.

Parashtrimet e Mbrojtësit të Viktimave

8. Mbrojtësi i Viktimave pretendon se viktimat 01 pësoi dëm fizik, mendor dhe material si pasojë e krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme të kryera nga z. Shala.

9. Ai më tej argumenton se viktimat 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08 kanë pësuar dëm mendor afatgjatë si edhe dëm material, si pasojë e krimeve të luftës të arrestimit arbitrar dhe torturës të kryera nga z. Shala kundër anëtarit të familjes së tyre (W04733), me të cilin kishin marrëdhënie të ngushtë.

Parashtrimet e Mbrojtjes

10. Në përgjigje, Mbrojtja argumenton se Mbrojtësi i Viktimave nuk identifikoi shkallën dhe përmasat e dëmit fizik të pësuar nga viktimat 01, dhe se si dëmi fizik dhe

mendor i pësuar nga viktima 01 ishte rezultat i drejtpërdrejtë i krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

11. Sa u përket viktimave 02 - 08, Mbrojtja gjithashtu argumenton se Mbrojtësi i Viktimave nuk ka vërtetuar standardin e kërkuar në lidhje me dëmin material.

12. Më gjerësisht, Mbrojtja argumenton se dëmi fizik dhe mendor i pësuar nga viktimat nuk u shkaktua drejtpërdrejt nga krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor, pasi veprimet që shkaktuan dëmin nuk u kryen nga z. Shala. Për rrjedhojë, sipas Mbrojtjes, z. Shala nuk mund të mbahet përgjegjës për kompensimin e dëmit material që pësuan viktimat. Për këto arsye, Mbrojtja i kërkon Trupit Gjykses të hedhë poshtë Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim dhe të hedhë poshtë kërkesën për lëshimin e një Urdhri për Zhdëmtim.

Vlerësimi i Trupit Gjykses

Viktima 01.

13. Trupi Gjykses mbështetet në konstatimet e bëra në Aktgjykim të cilat vërtetojnë se viktima 01 u mbajt në ndalim arbitrar dhe u torturua në FMK nga z. Shala dhe anëtarë të tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe se pësoi dëm fizik, mendor dhe material si rezultat i kësaj.

14. **Sa i përket dëmit fizik që pësoi viktima 01,** Trupi Gjykses gjykon se kjo viktimë u keqtrajtua rëndë gjatë gjithë kohës që u mbajt në ndalim. Ai u bë rregullisht objekt i rrahjes, ngacmimit dhe poshtërimit prej anëtarëve të UÇK-së, përfshirë z. Shala. Ai u mbajt i ndaluar në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi. Gjatë kohës që u mbajt në ndalim, viktima 01 u godit, ndër të tjera, me shufra metali, shkopinj bejsbolli dhe gome dhe – të paktën në një rast – me një armë zjarri. Ai u keqtrajtua për orë të tëra. Si rezultat i ndalimit dhe keqtrajtimit, ai pësoi lëndime të shumta, ndër të tjera edhe në kokë. Edhe sot e kësaj dite, ai ka vraga të dukshme nga keqtrajtimi fizik që pësoi. Ai vazhdon të ketë dhimbje në brinjë dhe eshtra dhe vuan nga dhimbje koke.

15. **Sa i përket dëmit mendor që pësoi viktima 01,** Trupi Gjykues mban parasysh se, kur u mbajt në ndalim në FMK, viktima 01 nuk u informua për arsyet e heqjes së lirisë, nuk e dinte sa do të zgjaste ndalimi dhe nuk pati mundësi të kontaktonte me familjen dhe botën e jashtme. Gjatë mbajtjes në ndalim në FMK, viktima 01 dëgjoi keqtrajtimin e rëndë të të ndaluarve të tjerë dhe pa lëndimet që kishin pësuar. Kjo i shkaktoi tension tejet të madh psikologjik. Edhe sot e kësaj dite, viktima 01 ka simptoma të rënda të çrregullimit të stresit pastraumatik (ÇSPT). Ai ka frikë për sigurinë e vet dhe të familjes së tij dhe ruhet gjithë kohën.

16. Gjithashtu, në lidhje me dëmin mendor që pësoi, Trupi Gjykues vëren se viktima 01 u etiketua nga personat që e mbanin të ndaluar, si “bashkëpunëtor” i autoriteteve serbe dhe “spiun”. Viktima 01 përshkroi se u ndie thellësisht i lënduar, konfuz, dhe i tradhtuar nga ky stigmatizim.

17. **Sa i përket dëmit material që pësoi viktima 01,** Trupi Gjykues konstaton se simptomat ÇSPT të viktimës 01 ishin aq të rënda saqë ia bënë të pamundur ta jetonte jetën ashtu si përpara ngjarjeve dhe të fitonte jetesën për vete dhe familjen. Trupi Gjykues është bindur se krimet për të cilat z. Shala u shpall fajtor dhe stigmatizimi shoqëror që shkaktuan, kontribuan në që viktima 01 të humbiste mundësi dhe ta kishte të pamundur të rifitonte pavarësinë e vet financiare dhe të mbante familjen e tij.

18. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues konstaton se viktima 01 pësoi dëm fizik, mendor dhe material, me pasoja afatgjata, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme për të cilat z. Shala u shpall fajtor.

Viktimat 02-08.

19. Trupi Gjykues konstaton se viktimat 02 - 08 pësuan dëm si viktima të tërthorta të krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe të torturës për të cilat z. Shala u shpall

fajtor, në lidhje me W04733-shin. Viktimat 02 - 08 ishin anëtarë të familjes së W04733-shit (viktima të tërthorta).

20. Fillimisht, Trupi Gjykues paraqet konstatimet që kanë të bëjnë me W04733-shin, në lidhje me të cilin anëtarët e familjes së tij pretendojnë se kanë pësuar dëm.

21. Trupi Gjykues rikujton se në Aktgjykim konstatoi përtej dyshimit të arsyeshëm se W04733 u ndalua arbitrarisht dhe keqtrajtua në FMK nga anëtarë të UÇK-së, ndër të cilët z. Shala. Ashtu si të ndaluarit e tjerë, W04733 u mbajt në kushte çnjerëzore dhe poshtëruese ndalimi. W04733 u rrah brutalisht dhe rregullisht, përfshirë edhe nga z. Shala. Si pasojë e keqtrajtimit, W04733 pësoi një numër lëndimesh dhe vragash, përfshirë një vragë në ballë, shenja djegieje në gjoks dhe shpatull, bërryl të lënduar dhe dhëmbë të thyer.

22. Trupi Gjykues gjithashtu vë në dukje se, ashtu si të ndaluarit e tjerë, W04733 përjetoi atmosferë frike dhe brutaliteti në FMK. Ai u detyrua të shihte vuajtjet dhe poshtërimin e të ndaluarve të tjerë, përfshirë edhe nga z. Shala, ndërsa edhe ai rrihej dhe poshtërohej në praninë e tyre. Ai u mor në pyetje rregullisht dhe u akuzua se bashkëpunonte me autoritetet serbe. Kjo pati pasoja të thella dhe afatgjata në mirëqenien psikologjike të tij: W04733 raportoi se përjetonte makthe dhe jetonte vazhdimisht me stres. Ai ishte vazhdimisht i irrituar. Ai gjithashtu ishte i frikësuar dhe ruhej gjithë kohën; madje kishte frikë të shkonte edhe te mjeku, pavarësisht nga lëndimet e rënda që kishte pësuar në FMK.

23. Pasojat e ndalimit arbitrar dhe keqtrajtimit të W04733-shit në shëndetin fizik dhe mendor të tij patën ndikim rrënues mbi familjen e tij, viktimat e tërthorta.

24. Sa i përket dëmit mendor që pësuan viktimat e tërthorta, ata përshkruan frikën dhe ankthin që përjetuan ngaqë nuk e dinin se ku ishte W04733 menjëherë pasi u arrestua. Ata gjithashtu përshkruan brengosjen që iu shkaktua kur panë gjendjen fizike dhe mendore të W04733-shit pas lirim: ai ishte i zbehtë, i palarë, i mbuluar në gjak, kishte plagë në tërë trupin dhe kishte humbur shumë peshë. Familja gjithashtu

pati vuajtje mendore prej pasojave afatgjata të ndalimit dhe keqtrajtimit mbi gjendjen fizike dhe psikologjike të W04733-shit. Atyre iu desh të mësonin të jetonin me ndryshimet në personalitetin dhe sjelljen e W04733-shit, si dhe me format me të cilat shprehej trauma e tij. Tre nga djemtë e W04733-shit e përshkruan babain e tyre si “i shkatërrur”, “në agresivitet”, “jo ashtu si e kam njoftë unë ma herët” dhe “i thyer”. Sipas saj, viktima 03 tregoi se krimet e kryera kundër W04733-shit ndikuan “n’gjendjen shëndetësore [...] të gjithë familja kemi pas strese, kemi fitu ndonjë sëmundje, ndonjë trauma, vetëm jemi përcjellë kështu me terapi, me medikamente”. Së fundi, akuzat që i bënë W04733-shit anëtarët e UÇK-së kontribuan edhe në stigmatizimin e familjes. Për rrjedhojë, familja nuk ndihej e sigurt, sepse kishin frikë se mund të pësonin më shumë dëm.

25. **Sa i përket dëmit material që pësuan viktimat e tërthorta**, Trupi Gjykues rikujton se si pasojë e ndalimit arbitrar dhe keqtrajtimit në FMK, W04733 nuk ishte më në gjendje të fitonte jetesën për familjen pasi u kthye. Si rezultat, familja mbeti pa kontribuesin kryesor të të ardhurave.

26. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se viktimat e tërthorta patën shpenzime në lidhje me kujdesin mjekësor që iu dha W04733-shit për trajtimin e lëndimeve fizike që pësoi në FMK, si dhe me shëndetin e tij që u përkeqësua gjatë viteve.

27. Së fundi, Trupi Gjykues thekson se, si pasojë e krimeve të kryera kundër W04733-shit në FMK dhe stigmës së shkaktuar, familja jetoi në frikë për sigurinë e anëtarëve të saj dhe, për këtë arsye, bëri zgjedhje dhe mori vendime që kufizuan perspektivat e ardhshme të tyre.

28. Duke u bazuar në sa më lart, Trupi Gjykues arrin në përfundimin se viktimat 02 - 08 pësuan dëm mendor dhe material, me pasoja afatgjata, si rezultat i krimeve të luftës të ndalimit arbitrar dhe torturës për të cilat z. Shala u shpall fajtor në lidhje me W04733-shin.

Urdhri për Zhdëmtim kundër z. Shala

29. Ky urdhër jepet drejtpërdrejt kundër z. Shala.

Përfituesit e zhdëmtimit

30. Përfituesit e zhdëmtimit janë viktimat 01 - 08.

Llojet dhe modalitetet e zhdëmtimit

31. Trupi Gjykues vë në dukje se shpallja e fajësisë dhe dënimi i shqiptuar në Aktgjykim tashmë përbëjnë një lloj mjeti juridik – në formën e njohjes – për tetë viktimat.

32. Gjithashtu, zhdëmtimi u jep viktimave mundësinë për të kërkuar dhe marrë drejtësi për krimet kundër tyre, ose një anëtar të familjes së tyre, të kryera më se dy dekada më parë. Së fundi, ai kontribuon në të drejtën e viktimave, familjeve të tyre dhe të komunitetit të tyre, për të pasur qasje në të vërtetën.

33. Bazuar në arsyet e përcaktuara në Urdhrin për Zhdëmtim, Trupi Gjykues gjykon se kompensimi për secilën nga tetë viktimat është lloji dhe modaliteti më i përshtatshëm i zhdëmtimit në këtë çështje gjyqësore. Sipas Trupit Gjykues, kompensimi do të mundësojë njëfarë lehtësimi financiar për viktimat.

Shkalla e përgjegjësisë së z. Shala për zhdëmtimet

Kërkesa e Mbrojtësit të Viktimave

34. Mbrojtësi i Viktimave kërkon në lidhje me viktimën 01: 10.000 euro për dëm fizik, 30.000 euro për dëm mendor dhe 60.000 euro për dëm material.

35. Në lidhje me viktimën 03, Mbrojtësi i Viktimave kërkon 10.000 euro për dëm mendor.

36. Në lidhje me viktimat 02, 04, 05, 06, 07 dhe 08, Mbrojtësi i Viktimave kërkon 8.000 euro për person për dëm mendor.

37. Së fundi, Mbrojtësi i Viktimave kërkon që një shumë e gjithsejtë prej 50.000 euro t'u akordohet viktimave të tërthorta 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08 për dëm material.

Vendimi i Trupit Gjykses

38. Së pari, z. Shala ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit që iu shkaktua të gjitha viktimave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të krimeve për të cilat u shpall fajtor. Kjo është pavarësisht nga format e ndryshme të përgjegjësisë penale ku u mbështet shpallja e fajësisë dhe pavarësisht nëse edhe persona të tjerë mund të kenë kontribuar në shkaktimin e dëmit.

39. Së dyti, Trupi Gjykses duhet të përcaktojë shumën për secilin lloj të dëmit – si edhe shumën e gjithsejtë të përgjegjësisë financiare të z. Shala – që i gjykon të arsyeshme, në përputhje me nenin 22(3) të Ligjit.

40. Krahas kësaj, në përcaktimin e shumës së përgjegjësisë financiare të z. Shala, Trupi Gjykses merr parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit që pësuan tetë viktimat dhe Kërkesën e Mbrojtësit të Viktimave për Zhdëmtim.

41. Gjithashtu, Trupi Gjykses merr parasysh legjislacionin përkatës të Kosovës. Ky legjislacion përcakton të drejtat dhe përfitimet që akordohen për kategori të ndryshme personash të prekur nga konflikti i armatosur në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999. Në këto kategori përfshihen: veteranët dhe civilët e dëmtuar gjatë konfliktit të armatosur; ata që morën pjesë në luftë; dhe familjarët e anëtarëve të UÇK-së dhe të civilëve të vdekur ose të zhdukur. Trupi Gjykses e konsideron këtë legjislacion si pikë reference për përcaktimin e zhdëmtimit që e gjykon të arsyeshëm në kontekstin e Kosovës.

42. Trupi Gjykses gjithashtu vë në dukje Udhëzuesin për Caktimin e Kriteve Orientuese dhe Lartësisë së Shpërblimit të Drejtë në të Holla të Dëmit Jo Material të Kosovës (Udhëzuesi i Kosovës), të cilit i referohet Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja. Trupi Gjykses thekson se Udhëzuesi i Kosovës përmban udhëzime lidhur me paditë civile në gjykatat e Kosovës dhe, si të tilla, ato nuk zbatohen drejtpërdrejt në proceset për zhdëmtim që kanë lidhje me çështjet gjyqësore për krime lufte/krime kundër

njerëzimit në Dhomat e Specializuara. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses gjykon se ato janë relevante vetëm në lidhje me vlerësimet e dobishme të shumave monetare për dëmin e pësuar, në kontekstin ekonomik aktual në Kosovë.

43. Trupi Gjykses gjithashtu merr parasysh aktekspertizat e dorëzuara nga Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtja në lidhje me dëmin material (përkatësisht, Aktekspertiza e Mbrojtësit të Viktimave dhe Aktekspertiza e Mbrojtjes).

44. Trupi Gjykses vë në dukje se Aktekspertiza e paraqitur nga Mbrojtësi i Viktimave bën vlerësimin e dëmit material të pësuar nga viktimat 01 dhe viktimat e tërthorta 02 - 08 si rezultat i krimeve të kryera nga z. Shala, përkatësisht, kundër viktimës 01 dhe W04733-shit. Këto vlerësime tregojnë përmasat e dëmit material individual të pësuar nga viktimat, sikurse do të ishte bërë në procese të zakonshme lidhur me dëme/kompensim. Gjithashtu, ato i tejkalojnë ndjeshëm zhdëmtimet individuale të kërkuara nga Mbrojtësi i Viktimave. Trupi Gjykses konstaton se, duke qenë se shifrat në këtë raport janë vetëm sugjeruese, ai mund t'i marrë parasysh, por ato nuk kanë fuqi detyruese mbi Trupin Gjykses për përcaktimin e zhdëmtimit.

45. Trupi Gjykses nuk mbështetet në vlerësimet e dhëna në Aktekspertizën e paraqitur nga Mbrojtja, për shkak se ajo ka një numër mangësish të rëndësishme që ndikojnë në kuadrin dhe vlefshmërinë e konstatimeve të bëra në të.

46. Së fundi, duke pasur parasysh konstatimet e lartpërmendura, Trupi Gjykses gjykon se shumat e kërkuara nga Mbrojtësi i Viktimave pasqyrojnë shkallën dhe përmasat e dëmit të pësuar nga tetë viktimat dhe janë të arsyeshme sikurse parashikohet në nenin 22(3) të Ligjit.

47. Bazuar në gjithë sa u tha më sipër, duke mbajtur parasysh shkallën dhe përmasat e dëmit të pësuar nga viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta, dhe duke vendosur për aspektet e paqarta në favor të personit të shpallur fajtor, Trupi Gjykses cakton shumën e gjithsejtë të zhdëmtimit që z. Shala ka përgjegjësi ta paguajë në 208.000 euro (dyqind e tetë mijë euro).

48. Rrjedhimisht, z. Shala urdhërohet t'u paguajë si kompensim për dëmin e shkaktuar:

- 100.000 euro viktimës 01;
- 10.000 euro viktimës 03;
- 8.000 euro për person viktimave 02, 04, 05, 06, 07 dhe 08; dhe
- 50.000 euro, bashkërisht viktimave 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08.

Vënia në jetë dhe zbatimi

Monitorimi dhe mbikëqyrja

49. Trupi Gjykues vëren se juridiksioni i tij në këtë çështje gjyqësore përfundon me nxjerrjen e Urdhrit për Zhdëmtim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues fton Kryetaren e Dhomave të Specializuara të caktojë një Gjykatës të Vetëm për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim.

Financimi i Urdhrit për Zhdëmtim

Nga personi i shpallur fajtor

50. Sa i përket zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykues rikujton se përgjegjësinë për pagesën e kompensimit për viktimat, të caktuar nga ky Trup Gjykues, e mban ekskluzivisht z. Shala.

51. Megjithatë, Trupi Gjykues thekson se në kohën e lëshimit të Urdhrit për Zhdëmtim, Trupi Gjykues nuk ka asnjë të dhënë nëse z. Shala është në gjendje ta paguajë plotësisht zhdëmtimin.

52. Në këto rrethana, Trupi Gjykues diskuton se cilët aktorë të tjerë mund të përfshihen në zbatimin e Urdhrit për Zhdëmtim.

Nga Kosova

53. Trupi Gjykues rikujton se, në kontekstin e procesit *Mustafa*, Ministria e Drejtësisë e Kosovës e informoi Trupin Gjykues se viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara mund t'u akordohet kompensim ose dëmshpërblim nga programi për kompensimin e viktimave të krimit, i krijuar në bazë të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Ky program kompensimi mund të aktivizohet kur është përcaktuar se personi i shpallur fajtor nuk është në gjendje të paguajë kompensimin, qoftë plotësisht apo pjesërisht.

54. Për të ruajtur anonimitetin e tetë viktimave që kërkojnë zhdëmtim në këtë proces gjyqësor në Dhomat e Specializuara dhe për të garantuar mbrojtjen e tyre, Trupi Gjykues urdhëron Administratoren, në koordinim me Mbrojtësin e Viktimave, që të kërkojnë kompensim prej Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimeve, në emër të tetë viktimave. Trupi Gjykues mban parasysh se, në rast nevojë, Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të Urdhrit për Zhdëmtim, mund të konfirmojë se tetë viktimat në emër të të cilave Administratorja/Mbrojtësi i Viktimave mund t'i paraqesin kërkesë Komisionit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, janë me të vërtetë viktimat të cilave u është akorduar kompensim në Urdhrin për Zhdëmtim.

55. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se duhet të parashikohen mënyra të tjera për zbatimin e plotë të Urdhrit për Zhdëmtim, duke mbajtur parasysh shumën maksimale për viktima që mund të akordohet nga Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimeve, që është më e ulët se shuma e akorduar në Urdhrin për Zhdëmtim.

56. Trupi Gjykues mban parasysh faktin se Kosova ende nuk ka ndërmarrë asnjë hap konkret për t'u përgatitur lidhur me nevojën për sigurimin e zhdëmtimit të viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Trupi Gjykues gjithashtu vëren se, nga ana tjetër, Kosova parashikoi nevojën për të mbështetur financiarisht mbrojtjen e të dyshuarve dhe të akuzuarve para Dhomave të Specializuara dhe vazhdon të ofrojë mbështetje të konsiderueshme.

57. Gjithashtu, Trupi Gjykues vëren se legjislacioni i Kosovës që trajton dëmin dhe lëndimet e pësuar në kontekstin e luftës së armatosur në Kosovë në vitet 1998-1999, i referohet ekskluzivisht viktimave të shkaktuara prej forcave të armikut (d.m.th. forcave serbe) dhe jo të gjitha viktimave të konfliktit të armatosur në Kosovë. Sipas Trupit Gjykues, këto ligje krijojnë diskriminim midis viktimave të këtij konflikti të armatosur.

58. Trupi Gjykues bën të ditur se, ndonëse nuk ka kompetenca të urdhërojë Kosovën të paguajë kompensimin që u është akorduar tetë viktimave, ai megjithatë e vlerëson të rëndësishme që – edhe një herë – t'i kujtojë Kosovës detyrimet e saj në lidhje me të drejtën e viktimave për mjet juridik efektiv, të mishëruar në nenin 54 të Kushtetutës dhe në marrëveshjet ndërkombëtare. Kjo e drejtë përfshin detyrën për të garantuar që ky mjet juridik të jetë i zbatueshëm.

59. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues përsëri i bën thirrje Kosovës të miratojë ligjet e nevojshme dhe të krijojë një mekanizëm zhdëmtues, për qëllimin e kompensimit të plotë të viktimave të krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Sipas Trupit Gjykues, kjo do të garantonte, brenda sistemit ligjor të Kosovës, trajtim të barabartë midis viktimave dhe të dyshuarve ose të akuzuarve në proceset e Dhomave të Specializuara.

60. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se, në krijimin e këtij mekanizmi zhdëmtues, duhet shqyrtuar mundësia e financimit të tij përmes buxhetit të Kosovës. Trupi Gjykues vëren se edhe mbrojtja e të dyshuarve dhe të akuzuarve para Dhomave të Specializuara financohet përmes atij buxheti. Sipas Trupit Gjykues, ky përdorim i barabartë i buxhetit të Kosovës do të promovonte mandatin e Dhomave të Specializuara sipas nenit 1(2) të Ligjit, të mbështetur nga Kosova dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, së bashku me shtetet e tjera kontribuese që mbështesin financiarisht punën e DHSK-së.

61. Në këtë aspekt, Trupi Gjykues vë në dukje se Komisioni Evropian ka theksuar kohët e fundit se:

“Kosova ka krijuar një fond që u jep ndihmë juridike të akuzuarve në Dhomat e Specializuara të Kosovës, si dhe mbështetje financiare familjeve të tyre, pa asnjë dëshmi për nevoja financiare. Por, deri më tani nuk është ofruar asnjë mbështetje financiare për viktimat për të cilat Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë konstatuar se kanë vuajtur si pasojë e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit. Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë lëshuar urdhrin e parë për zhdëmtimin e viktimave. Rrjedhimisht, nuk është e qartë se si do të kompensohen viktimat në mungesë të fondeve nga të akuzuarit, apo të një fondi të Kosovës për këtë qëllim. Është thelbësore që Kosova ta trajtojë këtë pabarazi në trajtim”.

Nga Dhomat e Specializuara

62. Gjithsesi, Trupi Gjykues thekson se, në qoftë se viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara nuk mund të realizojnë të drejtën e tyre për zhdëmtim, kjo e drejtë bëhet e pakuptimtë.

63. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues rikujton se në kontekstin e procesit *Mustafa* rekomandoi krijimin, me nismën e Dhomave të Specializuara dhe nën administrimin e Administratores, të një fondi për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Ky fond duhet të mbështetet në radhë të parë nga Kosova, duke pasur parasysh detyrimet e saj ndaj viktimave të përshkruara më lart, si edhe nga shtete dhe donatorë të tjerë që dëshirojnë të mbështesin viktimat.

64. Trupi Gjykues gjithashtu thekson se – aktualisht – ekziston një mundësi që Dhomat e Specializuara të marrin donacione vullnetare dhe të pakushtëzuara, si kontribute për pagimin e zhdëmtimeve u akordohen viktimave me një urdhrë përfundimtar për zhdëmtim të lëshuar nga Dhomat e Specializuara. Adresa e postës elektronike e caktuar posaçërisht për kërkim informacioni në lidhje me këto kontribute vullnetare, jepet në Urdhrin për Zhdëmtim.

65. Megjithatë, Trupi Gjykses thekson se ekzistenca e kësaj mundësie përmes Dhomave të Specializuara nuk e liron në asnjë mënyrë: (i) zotin Shala nga detyrimi për të kompensuar tetë viktimat në përputhje me Urdhrin për Zhdëmtim, dhe (ii) Kosovën nga përmbushja e detyrimeve të veta ndaj viktimave brenda një kohe të arsyeshme përmes krijimit të një mekanizmi për zhdëmtues, sikurse përmendet më lart.

66. Rrjedhimisht, për arsyet e përmbledhura më lart, Trupi Gjykses:

- a) **LËSHON** Urdhrin për Zhdëmtim kundër z. Shala;
- b) **KONSTATON** se viktimat 01, 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08 kanë vërtetuar, në bazë të standardit të vërtetimit të tërësisë së gjasave, se janë viktimat të krimeve për të cilat z. Shala u shpall fajtor;
- c) **VENDOS** t'u akordojë zhdëmtim viktimave të lartpërmendura;
- d) **AKORDON** zhdëmtim individual, në formën e kompensimit, përkatësisht për dëmin fizik, mendor dhe material të pësuar prej tij, për viktimën V01/04; dhe zhdëmtim individual dhe të përbashkët, në formën e kompensimit, për viktimat V02/04, V03/04, V04/04, V05/04, V06/04, V07/04 dhe V08/04, për, përkatësisht, dëmin mendor dhe material të pësuar prej tyre;
- e) **CAKTON** shumën e zhdëmtimit për të cilin z. Shala është përgjegjës, në 208.000 euro (dyqind e tetë mijë euro);
- f) **URDHËRON** z. Shala të paguajë, si kompensim për dëmin e shkaktuar:
 - 100.000 euro viktimës 01 për dëm fizik, mendor dhe material;
 - 8.000 euro për person viktimave 02, 04, 05, 06, 07 dhe 08 për dëm mendor;
 - 10.000 euro viktimës 03 për dëm mendor; dhe

- 50.000 euro gjithsej viktimave 02, 03, 04, 05, 06, 07 dhe 08 për dëm material;
- g) **KONSTATON** se zotit Shala i mungojnë mjetet financiare, në këtë fazë, për përmbushjen e Urdhrit për Zhdëmtim;
- h) **URDHËRON** Administratoren të marrë masat e nevojshme për vënien në jetë të Urdhrit për Zhdëmtim;
- i) **FTON** Kryetaren e Dhomave të Specializuara të caktojë një Gjykatës të Vetëm për monitorimin dhe mbikëqyrjen e vënies në jetë dhe zbatimit të këtij Urdhri për Zhdëmtim;
- j) **FTON** Kosovën të krijojë një mekanizëm të ri zhdëmtues për viktimat e krimeve të përfshira në juridiksionin e Dhomave të Specializuara për të korrigjuar pabarazitë aktuale në sistemin ligjor të Kosovës, sikurse përshkruhet në këtë Urdhër për Zhdëmtim; dhe
- k) **URDHËRON** Administratoren t'ia përcjellë këtë Urdhër për Zhdëmtim, në versionin e redaktuar publik të tij, Qeverisë së Kosovës.

* * * * *